

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7955  
E mërkurë, 18 dhjetor 2024  
Çmimi 0.50

Shqipëria hap grupkapitullin e gjashtë të negociatave me BE-në

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## THAÇI I KËRKON SPECIALES RESPEKTIMIN E KUSHTETUTËS SË KOSOVËS: S'KAM AMBICIE POLITIKE AS PËR KRYEMINISTËR E AS PËR PRESIDENT

FACE 4-5

### PROKURORËT KANË DËSHTUAR KUNDËR UÇK-së



Shkruan: Muhamet MAVRAJ

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sërish ka kërkuar nga Gjykata Speciale që të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Në seancën mbi ecurinë e çështjes për aktakuzën për pengim të drejtësisë, Thaçi ka thënë se

sikurse aktakuza për krime lufte edhe kjo u ngritën nxitimthi nga Zyra e Prokurorit të Specializuar pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. "Mosrespektimi i Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe normave të tjera ligjore nga palët në këtë

sallë të shenjtë për drejtësinë, paraqet rrezik për minimin e demokracisë në Kosovë, paraqet rrezik për cenimin e besimit qytetar. Prandaj, ftoj që të ruhet përmbajtja institucionale nga të gjithë edhe në këtë sallë", ka thënë Thaçi

### AKTUALE



ALI AHMETI NË PRISHTINË TAKON LIDERËT E OPOZITËS, NDEROHET ME "ÇELËSIN E QYTETIT" F. 6

SHEFI I NATO-S PËR SULMIN NË IBËR-LEPENC: PËRGJEGJËSIT TË SILLEN PARA DREJTËSISË F. 7

ARRESTOHEN PESË KOSOVARË, TENTONIN TË FUSNIN BARNA NË SHQIPËRI F. 3

### EKONOMI



KURTI THOTË SE QEVERIA KA NDIHMUAR RRETH 650 NDËRMARRJE NË PRONËSI TË GRAVE F. 8

LANSOHET PLATFORMA ELEKTRONIKE PËR TRAJNIMIN E PUNËTORËVE DHE PUNËDHËNËSVE PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË F. 8

### KANDIDATË ME TELASHE LIGJORE NË GARË PËR DEPUTETË F. 3



### MIRATOHEN KONKLUZIONET E MINISTRAVE TË BE-së PËR ZGJERIMIN F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**albi**  
MALL SUPERLIGA  
**SUPERLIGA**  
'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË, THAQI: SYNOJMË GARAT EVROPIANE F. 11

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Prokurorët kanë dështuar kundër UÇK-së

Muhamet MAVRAJ

Për plot 30 vjet përcjellim me shqetësim gjuetinë pa fre kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, propagandën e zezë dhe proceset gjyqësore kundër saj. Gjykata Speciale në Hagë është imponim i padrejtë, produkt i dhunshëm i projektit ruso-serb, pjesërisht shqiptar dhe i ca të tjerëve. Rrjedhimisht, koha po e vërteton se është Parti Speciale Politike. Që nga sajësat ruso-serbe të Martyt kanë ndryshuar radikalisht kontekstet politike e gjeopolitike në Evropë dhe në botë. Janë rrafshuar ndërkohë qytete të tëra dhe shtete, qindra mijëra njerëz janë vrarë në luftërat e Lindjes së Mesme dhe në Ukrainë, me plot episode gjenocidale. I tërë Perëndimi është në luftë me boshtin ruso-iranian. Nuk ka kuptim që




përballë tiranive të shkelet një komb i vogël aleat në Evropë me pretendimet e ndonjë shuplake ndaj spiujve. Ndryshimet politike që solli Gjykata prodhuan të kundërtën e pretendimeve për pajtim e drejtësi: rikthyen neverinë, stagnimin, tensionet dhe, çfarë nuk imagjinohej, edhe sanksionet; ftohjen me Perëndimin, ftohjen e Kosovës me vetveten në trojet shqiptare, dhe humbjen e besimit në këtë gjykatë monstruoze. Me paligjshmëritë e saj Gjykata po bëhet turpi i Evropës. Edhe ashtu është mafi financiare dhe gjykatë që po procedon me korrupsion, që nga lart deri të "dëshmitë". Po i shohim fytyrat nervoze të gjyqtarëve që gjithnjë e më haptas po bëhen prokurorë, fatkeqësisht, si Danica Marinkoviqi. Me dëshmitë e shumëpritura prej tyre te Zyrapit, Bujës, Çadrakut

dhe së fundmi të Bashotës do të duhej dhënë fund përpjekjes për të shpurdhur në akuzën me bazë në zinxhirin komandues. Është e kotë! Aty s'ka më shpresë për prokurorët. Ndryshimet politike në Kosovë që janë tashme imperativ duhet të ndriçojnë karakterin vërtetë të kësaj organizate që kurrë nuk krijoi besimin në drejtësi. Duhet të shtyhet përpara alarmimi i vonë i avokatëve. Krerët e UÇK-së janë fajtorë vetëm në sytë e pushtuesve serbë. Janë fajtorë vetëm pse e drejtuan Kosovën sigurt drejt lirisë dhe shtetformimit. Ata janë krijuar të historisë së re të kombit. Fatkeqësisht, ndonjëherë historia është e padrejtë me krijuesit e historisë. Kosova duhet të dalë fituese me këtë meselën e Hagës. Duhet të flasim me miqtë e vërtetë: Kosova nuk fitoi lirinë me krime, por me ta bashkë. Koha është tani.

< **Muhamet Mavraj** 3m ·  

vetem pse e drejtuan kosoven sigurt drejt lirisë dhe shtetformimit. Ata janë krijuar të historisë së re të kombit. Fatkeqësisht, ndonjëherë historia është e padrejtë me krijuesit e historisë. Kosova duhet të dalë fituese me këte meselën e Hages. Duhet të flasim me miqtë e vërtetë: Kosova nuk fitoi lirinë me krime, por me ta bashkë. Koha është tani.



 Comment as M...  

## Miratoohen konkluzionet e ministrave të BE-së për zgjerimin

**BRUKSEL, 17 DHJETOR** - Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme i Bashkimit Evropian, në takimin e ministrave të vendeve anëtare, ka miratuar të martën në Bruksel konkluzionet kushtuar procesit të zgjerimit. Nëpërmjet tyre vendet anëtare të BE-së kanë përsëritur përkushtimin për vazhdimin e procesit të zgjerimit, bazuar në parimin e meritave individuale të vendeve që synojnë integrimin në BE, por edhe u kanë bërë thirrje atyre ta vazhdojnë procesin e reformave si dhe t'i zgjidhin edhe mospajtimet bilaterale. Bashkimi Evropian, përmes këtyre konkluzioneve, u ka bërë thirrje edhe Kosovës edhe Serbisë që pa vonesa dhe pa parakushte ta zbatojnë Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve mes tyre, duke ua rikujtuar se ky është edhe kusht për përpërimin e tyre në procesin e integritimit në BE. Nga Kosova në veçanti kërkohet që të nisë pa vonesa themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa nga Serbia kërkohet që ta nisë njohjen e dokumenteve dhe simboleve të Kosovës. "Këshilli përsërit se

Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe aneksi për implementim, të miratuara në shkurt dhe mars 2023, duhet të respektohen dhe zbatohen në tërësi sa më shpejt që të jetë e mundur, pa parakushte, sikur edhe të gjitha obligimet e tjera nga BE-ja, po ashtu edhe të gjitha obligimet ekzistuese nga dialogu", thuhet në këtë dokument ku nënvizohet thirrja që ka të bëjë me krijimin e Asociacionit. "Kjo përfshin edhe themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, duke nisur me përcjelljen e draftit të Statutit të cilin palëve ua kishte prezantuar lehtësuesi i BE-së, përmes vendimit të Qeverisë së Kosovës, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës pa vonesa të reja", thuhet ndër të tjera. Në këto konkluzione, BE-ja do ta dënojë edhe një herë dhunën në veri të Kosovës, përfshirë sulmet e fundit në kanalit e Ibër-Lepencit, por edhe sulmet e vitit të kaluar në Banjskë dhe shpreh keqardhje të thellë se Serbia nuk ka ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për t'i sjellë



përgjegjësit para drejtësisë. "Këshilli mbetet thellësisht i shqetësuar për situatën në veri të Kosovës. Kosova dhe Serbia duhet të ndërmarrin hapa të qëndrueshëm për shtensionim, të përmbahen nga veprimet e njëanshme dhe provokuese që mund të çojnë në tensione dhe dhunë, dhe ta shmangin retorikën përçarëse", thuhet në këtë dokument. Nëpërmjet këtyre konkluzioneve BE-ja ka thënë se masat ndaj Kosovës do të hiqen paralelisht me hapat që duhet të ndërmarrë Kosova për t'i ulur tensionet në veri. Thëksohet një rikujtim për Kosovën dhe Serbinë se rruga e tyre drejt BE-së varet nga

progresi në procesin e normalizimit të raporteve dhe se mungesa e këtij progresi do të ndikojë që ato ta humbin rastin e duhur. "Në përputhje me deklaratën e përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së, BE-ja ka implementuar masat e kthyeshme ndaj Kosovës. BE-ja do t'i heqë gradualisht këto masa paralelisht me hapat e tjerë të Kosovës për ta shtensionuar situatën në veri. Këshilli do të mbetet duke u marrë me këtë çështje", theksohet në këtë dokument. Ndërkohë, vendet e BE-së kanë përhëndetur mbylljen e tre kapitujve në procesin e negociatave me Malin e Zi dhe hapjen e një grupkapitulli me

Shqipërinë. Sa i përket Serbisë, edhe pse Presidenca hungareze dhe Komisioni Evropian kanë bërë përpjekje maksimale që të hapet grupkapitulli 3, kjo nuk ka ndodhur pasi disa shtete e kanë bllokuar këtë vendim. Serbisë i rikujtohet se për të avancuar drejt BE-së duhet të bëjë më shumë përparim, sidomos në fushën e sundimit të ligjit, por edhe në normalizimin e raporteve me Kosovën. Serbia që nga dhjetori i vitit 2021 nuk ka hapur asnjë kapitull. Në konkluzione, BE-ja shprehet se do t'i rikthehet hapjes së kapitujve me Serbinë sapo Beogradi të shënojë progres në këto pika. Si kompromis vendet e BE-së janë pajtuar që Serbisë t'i dërgohet një letër nga Presidenca hungareze, nëpërmjet së cilës ftojnë Beogradin ta paraqesë pozicionin negociues për kapitujt në fjalë. Ky është një hap simbolik, por nuk parasheh edhe hapjen e kapitujve pasi për një gjë të tillë s'është nevojitet pajtimi i të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.



# Kosova nënshkruan marrëveshje me prodhuesin turk për fabrikën e municioneve

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Qeveria e Kosovës e ka nënshkruar një marrëveshje me prodhuesin shtetëror turk të industrisë së mbrojtjes, Makine ve Kimya Endüstrisi, për themelimin e një fabrike të municioneve në Kosovë, ka njoftuar Zyra e kryeministrit Albin Kurti.

Fabrika do të prodhojë "kalibra të ndryshëm të municioneve sipas standardeve të NATO-s", thuhet në njoftim. "Krahas makinerisë prodhuese, në kontratën e nënshkruar sot parashihet edhe trajnimi i stafit, mirëmbajtja për një kohë të caktuar, dhe pajisja me sisteme për testim të cilësisë dhe kalibrimit", ka thënë kryeministri Kurti.

Zyra e kryeministrit shtoi se, pas funksionimit, fabrika do të veprojë si ndërmarrje publike dhe si "markë 100 % vendore" e Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, tha se prodhimi i municioneve do të fillojë brenda "një afati të shkurtër", pa saktësuar se kur. Ai ka thënë se nuk mund të japë më shumë hollësi as rreth vendit ku do të



ndërtohet fabrika, për shkak të "ndjeshmërisë së informacionit". "Është e pamundur për mua të ndaj më shumë informacione rreth kontratës, sepse vetë kontrata është e klasifikuar", ka deklaruar Maqedonci për

televizionin publik të Kosovës, RTK.

Më 27 nëntor Kurti ka bërë me dije se ka nisur procesin drejt hapjes së një fabrike për prodhimin e municionit dhe për laboratorë për dizajnim të fluturakeve pa pilotë, të

njohur si dronë. Sipas tij, ky është "një hap i domosdoshëm për ta garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të ushtrisë". Maqedonci kishte thënë më parë se për këtë projekt janë koordinuar me partnerët

ndërkombëtarë, përfshirë ShBA-në, dhe se Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka asistuar me një "raport fizibiliteti". "Për hapjen e fabrikës shtetërore të municionit kemi pranuar një raport fizibiliteti nga Ministria e Mbrojtjes e Turqisë. Jemi në fazën e finalizimit të këtij projekti", kishte thënë ai në një konferencë për medie.

Verën e kaluar Kosova bleu dronë Bayraktar TB-2 nga Turqia. Kurti tha asokohe se me blerjen e tyre Kosova "është edhe më e sigurt", dhe shtoi se oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë trajnuar tashmë për përdorimin e dronëve. Se sa dronë ishin blerë, nuk ishte bërë e qartë atë kohë.

Buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2025 është paraparë të jetë 207.8 milionë euro, apo 54 milionë euro më shumë sesa këtë vit.

FSK-ja është aktualisht në proces të transformimit në ushtri të rregullt. Deri në fund të këtij procesi, më 2028, FSK-ja pritet t'i ketë mbi 7 500 pjesëtarë aktivë dhe rezervistë nga mbi 4 000 sa i ka aktualisht.

## Shqipëria hap grupkapitullin e gjashtë të negociatave me BE-në

TIRANË, 17 DHJETOR - Në Bruksel, më 17 dhjetor, u mbajt konferenca e tretë ndërqeveritare në mes të Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian dhe, gjithashtu, u hap grupkapitulli i gjashtë i negociatave për anëtarësim në BE.

Ky grupkapitull përfshin politikën e jashtme, të sigurisë dhe atë të mbrojtjes. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ky grupkapitull është më i lehtë për Shqipërinë. "Nuk është fort i vështirë sepse Shqipëria ka qenë gjithmonë në harmoni me politikën e BE-së sa i përket diplomacisë, sigurisë, edhe vetë shqiptarët janë mbështetës për këto lloj politikash dhe ne kemi bërë



një zgjedhje të qartë si komb, që ne duam të martohemi me BE-në, të harrojmë të gjitha

divorcet e së kaluarës", ka theksuar Rama.

Ai ka thënë se Shqipëria ka

shumë punë para, por nënvizoi se integrimi i Ballkanit Perëndimor do ta bënte Bashkimin Evropian më të fortë.

Marta Kos, komisionarja për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin, theksoi rëndësinë e hapjes së grupkapitullit të gjashtë për marrëdhëniet me jashtë, duke e cilësuar si një moment kyç në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. "Ky vendim është edhe një sinjal për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më tej që zgjerimi është prioritet për BE-në dhe në jemi të përkushtuar për të marrë rezultate të tjera dhe të mund ta plotësojmë dhe ta përforcojmë unionin tonë,

bashkimin tonë, në bazë të ndryshimeve gjeostrategjike që po ndodhin sot", ka thënë Kos.

Peter Szijjarto, ministër i Punëve të Jashtme i Hungarisë, vend që mban presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, tha se Shqipëria ka treguar përparim të shkëlqyer në gjashtë muajt e fundit krahasuar me 15 vitet e kaluara.

Në konferencën për medie, Rama ka thënë se Shqipëria ka si ambicie që negociatat të mbyllen më 2027 dhe më 2030 të realizohet anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Shqipëria i hapi zyrtarisht negociatat për anëtarësim më 15 tetor 2024.

## Arrestohen pesë kosovarë, tentonin të fusnin barna në Shqipëri

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Policia e Shtetit në Shqipëri ka bërë me dije se i ka arrestuar pesë kosovarë gjatë operacionit "Transit". Në një njoftim thuhet se ata do të futnin në Shqipëri barna të dyshuara të kontrabanduara, që dyshohet se përdoren si preparate për përgatitjen e lëndëve narkotike.

Gjatë operacionit janë arrestuar në flagrancë shtetasit

kosovarë B. Z., 45 vjeç, F. Z., 34 vjeç, A. I., 23 vjeç, A. G., 20 vjeç, A. M., 21 vjeç. "Nga kontrolli i ushtruar në 14 valixhe (bagazhet e të arrestuarve), janë konstatuar 1,057,840 tableta (barna) të dyshuara të kontrabanduara, me peshë 417.1 kg, që dyshohet se përdoren si preparate për përgatitjen e lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit fizik ndaj shtetasit B. Z., shërbimet e

policiisë i gjetën 300,000 euro, të cilat ai nuk i kishte deklaruar në kufi. Nga verifikimet e kryera dyshohet se 5 të arrestuarit do të futnin në Shqipëri dhe më pas në Kosovë, barna të blera në Jordani", thuhet në njoftim.

Në njoftim thuhet se medikamentet mjekësore, shuma 300 000 euro dhe gjashtë celularë u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.







# Kandidatë me telashe ligjore në garë për deputetë

**PRISHTINË, 17 DHJETOR** - Përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë thonë se e kaluara e disa kandidatëve të propozuar për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit është shqetësuese. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ua kufizon të drejtën për të garuar atyre personave që në tre vjetët e fundit janë dënuar me vendim të formës së prerë më së paku një vit burg.

Nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) thonë se në listat zgjedhore, të publikuara tashmë nga partitë politike, nuk kanë vërejtur ndonjë kandidat, i cili ka dënim të formës së prerë në tre vjetët e fundit. Por, sipas drejtorit ekzekutiv të këtij instituti, Ehat Miftaraj, në ato lista ka një numër të caktuar të kandidatëve që para më shumë se tre vjetësh janë dënuar për vepra penale të korrupsionit ose të tjera, si dhe të tillë që aktualisht janë në procedura gjyqësore. "Kjo na sjell në një situatë - si IKD e kemi thënë vazhdimisht - që e cenon integritetin e kandidatëve, të Kuvendit, por edhe të institucioneve të tjera", thotë Miftaraj për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, përfshirja e figurave të tilla për deputetë është qasje jo e mirë e partive

politike, të cilat në fushatat e kaluara zgjedhore, por edhe në parafushtatën aktuale promovojnë sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, luftën kundër korrupsionit dhe integritetin institucional. "Kur të njëjtat parti i promovojnë këto në plan-programet e tyre dhe të njëjtat propozojnë kandidatë që kanë probleme me ligjin... besoj që, në njëfarë mënyre, kjo e dëshmon më së ashpri profilizimin e tyre", thotë Miftaraj.

Burbuqe Kastrati nga Lëvizja FOL - që promovon përmirësimin e cilësisë dhe zbatimit të politikave të integritetit të institucioneve publike - thotë se përzgjedhja e kandidatëve që kanë pasur ose kanë probleme me ligjin, tregon mungesën e vullnetit politik të partive për të vendosur standarde të qarta të etikës. Kjo qasje, sipas saj, mund t'u hakmerret vetë atyre. "Përballja me akuzat e dëmton reputacionin e këtyre kandidatëve në fjalë. Po ashtu, ka tendencë që ta ulë besimin e publikut në institucione dhe në partitë politike të Kosovës", vlerëson Kastrati.

Nga IKD-ja dhe Lëvizja FOL nuk i specifikojnë emrat e kandidatëve për deputetë që kanë pasur ose kanë probleme

me ligjin. Por, thonë se brenda pak ditësh do t'i publikojnë analizat e tyre, që përfshijnë edhe emrat e tyre.

Në një postim të mëhershëm në rrjetet sociale, Miftaraj shkroi se listës me kandidatë të tillë "i prin Lëvizja Vetëvendosje nga numri, pasuar nga AAK-ja (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës)".

Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë "lista më të pastra", sipas tij.

## Çfarë thonë partitë politike?

"Radio Evropa e Lirë" kërkoi komente nga Lëvizja Vetëvendosje në pushtet lidhur me këtë temë, por nuk mori përgjigje.

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës thonë se nuk kanë asnjë kandidat në listë që bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Shefi i shtabit zgjedhor të AAK-së, Muharrem Nitaj, thotë se në listën e kësaj partie nuk ka persona që në tre vjetët e fundit janë dënuar me vendim të formës së prerë. Por, pa e përmendur me emër, pranon se një nga kandidatët e AAK-së, aktualisht është në procedurë gjyqësore. "Mesa di unë, është

një kandidat që është në procedurë gjyqësore, mirëpo që nuk i ka përfunduar akoma procedura. Ju e dini parimin e shenjtë në drejtësi - prezumimin e pafajësisë - derisa vendimi nuk është i formës së prerë...", thotë Nitaj për "Radion Evropa e Lirë".

Prezumimi i pafajësisë nënkupton që një i akuzuar për kryerjen e një veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të faktehet fajësia e tij.

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Mimoza Ahmetaj, thotë se në listën zgjedhore të kësaj partie "nuk ka asnjë kandidat që është në procese gjyqësore, apo që ka verdikte të prera". Fokus i partisë, sipas saj, ishte lista e pastër. "...të sjellim kuadro të reja, që konsiderojmë se mund t'i shërbejnë shoqërisë dhe shtetit të Kosovës si dhe, absolutisht, nuk kanë probleme me ligjin", thotë Ahmetaj për "Radion Evropa e Lirë".

Në listën zgjedhore të Lidhjes Demokratike të Kosovës, po ashtu, nuk ka asnjë kandidat që ka pasur ose ka probleme me ligjin, deklaroi nënkryetari i saj, Lutfi Haziri. Sipas tij, kandidatët e LDK-së nuk kanë, madje, as ndonjë dënim për kundërvajtje. "Nëse e kemi ditur [që ka probleme me

ligjin], ne nuk e kemi lejuar në listë... Fundja, politika është besim. Me njerëz që e kanë integritetin e dëmtuar, të rrënuar, të dënuar për çfarëdo veprë qoftë, nuk mund të sigurosh qeverisje të mirë dhe me duar të pastra", thotë Haziri për "Radion Evropa e Lirë".

## Çfarë thonë qytetarët?

Mirjeta Morina, juriste nga Prishtina, vlerëson se përderisa nuk ka ndonjë vendim të prerë të gjykatës për cilindo person, atij nuk mund t'i ndalohej të kandidojë për deputet. Megjithatë, ajo nuk e sheh si veprim të duhur të partive politike përfshirjen e personave që kanë ose kanë pasur çfarëdo problemesh me ligjin. "Nuk mendoj se është më e mira e mundshme. Mendoj se mund t'u japim më shumë hapësirë njerëzve të rinj", thotë Morina.

Listat me figura të tilla janë zhgënjyese për pensionistin Murtez Rizani. "Për nder, nëse unë e di që ka njerëz të tillë, nuk do t'ua jepja votën. Pra, edhe nëse e dua atë parti, nuk do t'ia jepja votën", thotë ai. E për Dritëro Bekajn, me profesion dentist, listat me ata emra nuk janë tjetër veçse "hipokrizi". "Ata të na tregojnë



# Thaçi i kërkon Speciales respektimin e Kushtetutës së Kosovës: S'kam ambicie politike as për kryeministër e as për president

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sërish ka kërkuar nga Gjykata Speciale që të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Në seancën mbi ecurinë e çështjes për aktakuzën për pengim të drejtësisë, Thaçi ka thënë se sikurse aktakuza për krime luftarake edhe kjo u ngritën nxitimthi nga Zyra e Prokurorit të Specializuar pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. “Mosrespektimi i Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe normave të tjera ligjore nga palët në këtë sallë të shenjtë për drejtësinë, paraqet rrezik për minimin e demokracisë në Kosovë, paraqet rrezik për cenimin e besimit qytetar. Prandaj, ftoj që të ruhet përmbajtja institucionale nga të gjithë edhe në këtë sallë”, ka thënë Thaçi

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

HAGË, 17 DHJETOR - Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes për aktakuzën për pengim të drejtësisë, ish-presidenti Hashim Thaçi ka theksuar se dy aktakuzat ndaj tij janë ngritur nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar pak para zgjedhjeve në Kosovë. Ai ka thënë të martën se aktakuza e parë u ngrit pak muaj para se të rizgjidhej president i Kosovës, ndërsa tash aktakuza e fundit i është ngritur dy muaj para zgjedhjeve elektorale. “Siç e tha edhe avokatja, para se të deklarohem dëshiroj të shtoj edhe diçka. Pikërisht në këtë fazë të hershme të këtij procesi për mbarëvajtjen e rregullt kushtetuese dhe ligjore që duhet të ndodhë. Ju e dini që para katër vjetësh, në nëntor 2020, u ngrit aktakuzë kundër meje vetëm tre muaj para se të rizgjidhesha president i vendit. Tash para dhjetë ditësh nxitimthi, Zyra e Prokurorit prezantoi aktakuzë shtesë vetëm dy muaj para zgjedhjeve parlamentare në Kosovë”, ka thënë Thaçi.

Thaçi shtoi se nuk ka asnjë ambicie politike për ndonjë pozitë të caktuar në Kosovë. “Unë dua ta sqaroj edhe njëherë se unë nuk jam pjesë e garës politike dhe as nuk kam ndonjë ambicie politike as për president, as për kryeministër, as për deputet e as për ndonjë ambicie tjetër për ndonjë pozitë tjetër publike”, është shprehur Thaçi. Thaçi ritheksoi se nuk paraqet rrezik për askënd në kuptimin politik apo për ndonjë projekt qeverisës. “Po theksoj që nuk jam pengesë e as nuk paraqes rrezik për askënd në kuptimin politik apo për ndonjë projekt qeverisës. Gjithë jetën time kam punuar për lirinë dhe shtetin e Kosovës me vizionin për anëtarësim në NATO, BE në raport special të përjetshëm me Shtetet e Bashkuara të



Amerikës”, ka thënë ai. Ish-presidenti Thaçi ka thënë se mosrespektimi i Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës e minon demokracinë në vendin e tij. “Por, e nderuara gjyqtare, dëshiroj të ritheksoj dhe nënvizoj domosdoshmërinë e respektimit të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës në këtë sallë. Mosrespektimi i Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe normave të tjera ligjore nga palët në këtë sallë të shenjtë për drejtësinë, paraqet rrezik për minimin e demokracisë në Kosovë, paraqet rrezik për cenimin e besimit qytetar. Prandaj, ftoj që të ruhet përmbajtja institucionale nga të gjithë

edhe në këtë sallë”, ka thënë ish-presidenti Thaçi. Prokuroria synon t'i thërrasë të paktën tre dëshmitarë për të dëshmuar në gjyqin e Gjykatës Speciale kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe katër të dyshuarve të tjerë, të cilët akuzohen për pengim të drejtësisë. Prokurori Joshua Hafetz tha gjatë kësaj seance për ecurinë e këtij procesi në Gjykatën e Hagës, se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka një dëshmitar dhe synon të thërrasë edhe të tjerë për të dëshmuar në këtë rast. “Ne synojmë t'i thërrasim tre dëshmitarë të paktën, duke

përfshirë dëshmitarin që është i përmendur me emër dhe në bazë të të cilit është mbështetur dokumentacioni i aktakuzës”, ka theksuar Hafetz. ZPS-ja është mbështetur në dy deklarata të një dëshmitari për ta përpiluar aktakuzën kundër Thaçit, ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, dhe Fadil Fazliut. Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ngriti aktakuzë të re kundër Thaçit dhe të tjerëve në fillim të dhjetorit, dhe i akuzon ata për

“përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e krimeve të luftës në rastin Thaçi dhe të tjerët”. Gjykata Speciale është institucion që funksionon sipas ligjeve të Kosovës, por selinë e ka në Hagë të Hollandës. Gjatë seancës të hënën, gjykatësja Marzhori Maselo i pyeti Thaçin dhe Smakajn nëse donin të deklaroheshin rreth fajësisë në lidhje me akuzat me të cilat ngarkohen, por ata nuk pranuan përsëri. Kuçi, Kilaj dhe Fazliu janë deklaruar të pafajshëm në seancat e tyre fillestare javën e kaluar.

neve për ligjin - çdo ditë na thonë se duhet respektuar ligji - e vetë nuk e respektojnë”, shprehet Bekaj.

## Qytetarët si “filtër”

Përkundër që Kushtetuta dhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme nuk e ndalojnë kandidimin për deputetë të

personave që nga gjykata nuk kanë aktvendim të prerë me dënim prej një viti burg në tre vjetët e fundit, Miftaraj thotë se partitë politike është dashur t'i zbatojnë praktikatat më të mira evropiane. Sipas tij, ato nuk do të duhej të përfshinin në lista zgjedhore persona, që nga publiku mund të perceptohen si “të papërshtatshëm” për

funksione të larta. “Unë mendoj se filtri më i mirë tani do të jetë qytetari, votuesi, i cili gjatë plotësimit të fletëvotimit me 10 kandidatë, do të duhej të sigurohej që t'i votojë vetëm ata emra që janë të pastër dhe që nuk kanë probleme me ligjin”, thotë Miftaraj. “Kjo situatë kërkon reforma të brendshme partiake”, shton në anën tjetër

Kastrati. Sipas saj, “duhet të rritet edhe vetëdija e qytetarëve që njerëzit që kanë probleme ligjore, të mos votohen”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet që deri më 25 dhjetor ta përfundojë verifikimin dhe certifikimin e kandidatëve të partive politike që do të garojnë në zgjedhjet e 9 shkurtit, 2025. Në zgjedhjet e fundit, më 2021,

KQZ-ja tha se në mesin e 28 subjekteve politike që garuan, 15 prej tyre kishin kandidatë me probleme me ligjin. Nga rreth 1.080 kandidatë që u paraqitën atëkohë, KQZ-ja nuk certifikoi 47 prej tyre, të cilët ishin shpallur fajtorë për vepra penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre vjetët e fundit.



# Ali Ahmeti në Prishtinë takon liderët e opozitës, nderohet me 'Çelësin e Qytetit'

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka qëndruar të martën në Prishtinë. Ai është takuar me liderët e opozitës, me të cilët ka biseduar për zhvillimet politike në Kosovë dhe për sfidat e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Ali Ahmetin e ka pritur në takim edhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i cili i ka dhuruar kryetarit të BDI-së "Çelësin e Qytetit". Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se takimet me liderin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Ali Ahmetin, janë gjithmonë të veçanta, kuptimplota dhe të sinqerta. "Edhe sot pata kënaqësinë ta pres në selinë e PDK-së dhe të diskutojmë për bashkëpunimin tonë dhe për sfidat e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë. Kosova dhe Maqedonia e Veriut duhet të thellojnë bashkëpunimin e tyre ndërfqinjësor, edhe në funksion të mbrojtjes të arriturave të deritanishme dhe avancimit të drejtave të shqiptarëve atje. Cenimi, në çfarëdo forme i përdorimit të gjuhës shqipe, si një e drejtë kushtetuese për shqiptarët atje, nuk i kontribuon bashkëjetesës ndëretnike. Së bashku me kryetarin Ahmeti, ritheksuam përkushtimin tonë të palëkundur për kultivimin e paqes dhe avancimin e integritimit evropian të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Roli i shqiptarëve në përgjithësi, dhe i Ali Ahmetit në veçanti, mbetet thelbësor në këtë rrugëtim", ka thënë Krasniqi.

Ahmeti ka takuar edhe kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, në një kohë kur stabiliteti dhe zhvillimi rajonal mbeten të rëndësishme për të dyja vendet. "Duke njohur kontributin e z. Ahmeti dhe të BDI-së për forcimin e rolit politik të



shqiptarëve, kryetari Abdixhiku vlerësoi domosdoshmërinë e ruajtjes së të arriturave historike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndëreshqiptar. Shqiptarët janë faktorë vendimtarë për stabilitetin dhe prosperitetin e Maqedonisë së Veriut. Gjuha shqipe dhe historia e shqiptarëve përbëjnë identitetin të patjetërsueshëm", ka theksuar Abdixhiku.

Ahmeti çmoi lart rolin historik të LDK-së dhe të ish-presidentit Rugova në pavarësimin e Kosovës dhe në ndërtimin e shtetit. Po ashtu, Ahmeti vlerësoi lart lidhshimin e kryetarit Abdixhiku në procesin e rikthimit të forcës elektorale të LDK-së, si dhe i uroi sukses në zgjedhjet e 9 shkurtit. Ali Ahmeti është takuar edhe me liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

Ky i fundit ka thënë se Ahmeti është një prej figurave më të respektuara shqiptare. "Kontributi i tij në të gjitha proceset nëpër të cilat kanë kaluar shqiptarët në Ballkan, të paktën në 30 e sa vitet e fundit, ka qenë i jashtëzakonshëm. Pata kënaqësinë që sot ta zhvilloj me të një bisedë vëllazërore për sfidat nëpër të cilat po kalojnë vendet tona. Bashkëpunimi i Kosovës me Maqedoninë e Veriut duhet të jetë prioritet në marrëdhëniet tona, dhe shqiptarët në Maqedoni të Veriut janë faktorë përcaktues mbi të cilin zhvillohen këto marrëdhënie. Kosova do të jetë gjithmonë mbështetëse e vëllazërve tanë në kërkesat e tyre legjitime për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave, duke përfshirë edhe përdorimin e gjuhës shqipe në RMV", ka theksuar Haradinaj pas takimit.



## Haxhi Shala dhe Sabit Januzi pranojnë se e frikësuan një dëshmitar

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka njoftuar të martën se ish-eporri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Haxhi Shala, dhe Sabit Januzi kanë pranuar akuzën për frikësimin e një dëshmitari dhe pengimin e drejtësisë, në marrëveshje me këtë zyrë për pranimin e fajësisë. "Të pandehurit janë akuzuar për frikësim gjatë procedurave penale dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", thuhet në njoftim. Në një reagim lidhur me marrëveshjet, prokurorja e specializuar, Kimberly West, ka deklaruar se "arritja e zyrës sonë për t'i përfunduar këto marrëveshje është dëshmi e forcës së hetimeve tona lidhur me çështjet e frikësimit dhe pengimit të drejtësisë".

Dhomat e Specializuara, po ashtu, konfirmuan këto dy marrëveshje për pranimin e fajësisë, ku "secila bazohet në faktet e pranuar", me çka të akuzuarit pranojnë se disa

fakte të paraqitura në aktakuzë do të vërtetoheshin jashtë dyshimit të arsyeshëm dhe janë të vërteta dhe sakta". Sipas tyre, "Rregullorja e procedurës dhe e provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës lejon që prokurori i specializuar dhe mbrojtja të arrijnë marrëveshje për pranimin e fajësisë, e cila duhet të miratohet nga trupi gjyqësor para se të hyjë në fuqi". "Trupi gjyqësor aktualisht është duke i shqyrtuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë në këtë çështje gjyqësore", thuhet në komunikatën e Dhomave të Specializuara.

Seanca për marrëveshjet për pranimin e fajësisë është caktuar më 18 dhjetor. Këto marrëveshje nuk janë bërë ende publike, njofton ky institucion, dhe shtoi se ato do të publikohen "sapo të bëhen të disponueshme versionet e redaktuara publike dhe parashtimet përkatëse". Gjyqi ndaj Shalës dhe Januzit,



së bashku me Ismet Bahtjarin, ishte planifikuar të hapej më 14 nëntor 2024. Aktakuza kundër Haxhi Shalës u konfirmua më 4 dhjetor 2023 nga gjykatësi i procedurës paraprake. Ai u arrestua më 11 dhjetor 2023, dhe një ditë më vonë u transferua në qendrën e paraburgimit në Hagë. Prokuroria në Hagë e ka ngarkuar Shalën me aktakuzë

me tri pika: tentativë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, tentim për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi dhe për frikësim gjatë procedurës penale. Sipas aktakuzës, në periudhën

midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtjarin (të dy të akuzuar nga Specialja), kontaktuan një dëshmitar. Aktakuza thotë se ata, veçmas, takuan dëshmitarin, në dy raste, "për ta nxitur atë ta tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndër të cilat përmes kërcënimit të rëndë apo premtimit për përfitime".

Më 15 dhjetor 2023, Shala ishte deklaruar i pafajshëm për pikat me të cilat e akuzon prokuroria në Hagë. Ismet Bahtjari dhe Sabit Januzi u arrestuan më 5 tetor 2023 në bazë të një urdhërarrestit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHKS). Prokuroria, në dhjetor të vitit të kaluar, kishte propozuar që çështja Januzi dhe Bahtjari të bashkohej me çështjen Shala në një gjykim të vetëm. (REL)



## Osmani udhëton në Bruksel, përfaqëson Kosovën në Samitin BE - Ballkani Perëndimor

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për Bruksel, ku do të marrë pjesë në Samitin BE - Ballkani Perëndimor përkrah

liderëve të vendeve anëtare të BE-së, si dhe atyre nga Ballkani Perëndimor. Temë kryesore e Samitit pritet të jetë zgjerimi i BE-së me përfshirjen e Ballkanit

Perëndimor, si dhe do të trajtohen në veçanti: Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, Plani Ekonomik dhe i Investimeve, Agjenda e Gjellbër dhe Digjitale për

Ballkanin Perëndimor, si dhe fusha të tjera si Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë, luftimi i kërcënimeve hibride dhe kibernetike dhe migracioni.



## Shefi i NATO-s për sulmin në Ibër-Lepenc: Përgjegjësit të sillen para drejtësisë

BRUKSEL, 17 DHJETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka bërë thirrje të hënën që përgjegjësit e sulmit kundër kanalit të ujit të Ibër-Lepencit në veri të Kosovës muajin e kaluar, të sillen para drejtësisë. "Sulmi në kanal in ujor në veri të Kosovës, më 29 nëntor, nënvizon se sa i brishtë është stabiliteti në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Rutte në një konferencë shtypi me kryeministrin e Malit të Zi, Millojko Spajiq, në Bruksel. Shpërthimi i 29 nëntorit në kanal in e ujit në Varragë të Zubin Potokut - prej nga furnizohen me ujë disa qytete dhe termoelektrana të vendit - u shkaktua nga rreth 20 kilogramë eksplozivë, sipas autoriteteve të Kosovës, të cilat e cilësuan atë më të rëndin në infrastrukturën kritike të vendit që nga lufta e viteve 1998/99.

Autoritetet e Kosovës janë duke e hetuar shpërthimin, për të cilin e akuzojnë Serbinë. Serbia i ka mohuar akuzat dhe ka thënë se edhe vetë po e heton këtë sulm.

Rutte ka pohuar se "tani është thelbësore që të nxirren faktet" rreth sulmit dhe përgjegjësve të mundshëm. Ai ka theksuar



se dëshiron ta falënderojë komandantin e KFOR-it për "dislokim të shpejtë" të trupave për ta mbrojtur infrastrukturën kyçe të Kosovës.

"Mbetemi të përkushtuar që të sigurojmë që KFOR-i ta përmbushë mandatin e tij të OKB-së", ka deklaruar Rutte. KFOR-i, i cili ka rreth 4 700

ushtarë, është përgjegjësi i tretë për sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

Javën e kaluar ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ende nuk ka prova se kush mund ta ketë kryer sulmin ndaj kanalit

të ujit të Ibër-Lepencit, por shtoi se "ne mendojmë se do të gjenden prova".

Hovenieri e përsëriti qëndrimin e tij të mëparshëm se qeveria amerikane "nuk është në gjendje të thotë se kush është përgjegjës".

Ekspertët ligjorë dhe të sigurisë thonë se përcaktimi i saktë i përgjegjësisë për

sulmin në kanal in e Ibër-Lepencit është kritik, duke shtuar se përfshirja ndërkombëtare, sidomos e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, do ta rriste besueshmërinë e hetimeve, por do të ndihmonte edhe në uljen e tensioneve.

Mark Ellis, drejtor ekzekutiv i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve, me seli në Londër, tha për "Radion Evropa e Lirë" se mbështet idenë e një hetimi të tillë, në mënyrë që "situata të mos përshkallëzohet në diçka shumë më serioze". "Mënyra më e mirë për të dalë nga kjo rrugë pa krye, është që të bëhet një vlerësim i pavarur, faktik dhe objektiv i asaj që ka ndodhur", ka thënë Ellis për "Exposenë".

Kanali Ibër-Lepenc furnizon me ujë nga Liqeni i Ujmanit gjithë veriu të Kosovës, rajonin e Mitrovicës, Prishtinën me rrethinë, si dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj.

Derisa furnizimi i KEK-ut me ujë për ftohjen e termoelektraneve të saj nuk u ndikua, shpërthimi shkaktoi reduktime të përkohshme të ujit në disa pjesë të vendit.

## Për dhjetë muaj në Kosovë lindën mbi 22 mijë fëmijë, kryeson gjinia mashkullore



PRISHTINË, 17 DHJETOR - Nga janari deri në tetor të këtij viti në Kosovë janë regjistruar 22 418 lindje, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Meshkujt vazhdojnë të kryesojnë me numër, pasi gjatë kësaj periudhe kanë lindur 11 651 djem dhe 10 767 vajza.

Vetëm në muajin tetor janë

regjistruar 2 367 lindje, nga të cilat 1 212 janë meshkuj dhe 1 155 femra. Ky numër është pothuajse i barabartë me atë të muajit shtator, kur lindën 2 370 fëmijë (1 251 meshkuj dhe 1 119 femra).

Në muajin gusht janë regjistruar 2 346 lindje, ndërsa në korrik ky numër ka qenë më i lartë, me 2 442 lindje. Në qershor janë

regjistruar 2 370 lindje, në maj 2 300 dhe në prill 2 036.

Muajt e parë të vitit ka pasur një ritëm pak më të ulët: në mars lindën 2 042 fëmijë, në shkurt 1 929, dhe në janar 2 216 fëmijë. Këto statistika reflektojnë trendin e lindjeve në Kosovë për vitin 2024 dhe ndihmojnë në analizimin e zhvillimeve demografike në vend.

## Hamza premtonte investime në arsim dhe paga 50 % më të larta për mësimdhënësit

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, ka pritur në takim kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj. Hamza ka thënë se i mbështet kërkesat e Sindikatës së Arsimit, sepse mbështetja e saj është mbështetje për një shoqëri

më të arsimuar dhe më të zhvilluar.

Ai ka thënë se me të kryeministër do të ketë rritje të investimeve në arsim dhe paga 50 % më të larta për mësimdhënësit. "Digjitalizim të shkollave dhe integrim të teknologjisë në mësimdhënie. Bursa për

nxënësit dhe studentët në mënyrë që asnjë i ri të mos mbetet prapa për shkak të gjendjes ekonomike. Politika që rikthejnë dinjitetin e mësuesit dhe e bëjnë arsimin prioritet kombëtar. Suksesi i tyre është suksesi i Kosovës. Dhe, Kosova mundet ma mirë!", ka thënë Hamza.





## Bruto Produkti Vendor në tremujorin e tretë 2024 shënon rritje

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin e tretë 2024, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak.

Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor janë: Industria përpunuese 5,30 %; Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të

mbeturinave, rehabilitimit 4,60 %; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 3,78 %; Ndërtimtaria 3,60 %; Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 3,30 %; Informacioni dhe komunikimi 2,84 %; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 2,24 %; Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e

akomodimit dhe shërbimit ushqimor 3,15 %; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 1,22 %; Aktivitete të pasurive të paluajtshme 0,76 % dhe Administrata publike 0,74 %. Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve 9,62 %; Importi i mallrave dhe shërbimeve 9,23 %; Formimi i bruto kapitalit 7,62 % Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH 3,24 % dhe Shpenzimet e konsumit final të qeverisë 2,38 %.



## Kurti thotë se qeveria ka ndihmuar rreth 650 ndërmarrje në pronësi të grave

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në tryezën me partnerët ndërkombëtarë për fuqizimin ekonomik të grave nga komunitetet joshumicë, të organizuar nga Zyra e Kryeministrit. Ky ishte takimi i katër radhazi i kësaj natyre dhe kryeministri Kurti theksoi se kjo është qeveria e parë që ka ftuar partnerët në këtë format, me qëllim për ta përmirësuar koordinimin dhe për t'i identifikuar prioritetet tona të përbashkëta.

Çështja e trajtuar në këtë takim ishin sfidat e veçanta dhe urgjenca e fuqizimit ekonomik të grave të komuniteteve joshumicë në vendin tonë, temë e cila u konsiderua e rëndësishme nga të dyja palët.

Disa nga sfidat e përmendura nga kryeministri gjatë këtij takimi ishin niveli i ulët i pronësisë dhe trashëgimisë për të gjitha gratë në Kosovë, niveli i ulët i statusit socio-ekonomik të familjeve, përgjegjësitë më të mëdha të kujdesit të grave në krahasim me burrat, si dhe përqindja e lartë e të gjitha grave që punojnë në tregun e punës joformal.



Mirëpo, pavarësisht prej sfidave, kryeministri u shpreh se situata po përmirësohet në bazë të arritjeve të bëra gjatë qeverisjes. "Për t'i adresuar çështjet e mungesës së kapitalit të grave, ne kemi nxitur me sukses regjistrimin e pronës në emër të burrit dhe gruas dhe kemi kushtuar një total prej 11 milionë eurosh që nga viti 2021 për t'i mbështetur gratë sipërmarrëse për t'i hapur bizneset e tyre, duke ndihmuar rreth 650 ndërmarrjet në pronësi të grave", ka deklaruar ai.

Në këtë kontekst, u veçua edhe

fakti që 100 mijë gra kanë hapur llogari bankare për herë të parë, të nxitura pjesërisht përmes skemës për pagesat për gratë lehona, ndërkaj 55 % e të punësuarve përmes programit "Qeveria për familjet" janë gra dhe 51 % e përfituesve nga platforma Superpuna janë gra. "Me këtë qasje ne kemi arritur një rënie të papunësisë më të madhe për gratë sesa për burrat: papunësia për gratë u ul nga 30 % në 17 % kur krahasojmë tremujorin e parë të 2021-s, në fillim të qeverisë sonë, me tremujorin e fundit të 2023-s", ka theksuar Kurti.

Për mundësitë ndaj komuniteteve joshumicë, kryeministri Kurti foli edhe për disa iniciativa specifike, sikurse procesi i verifikimit të diplomave të universitetit, për t'iu mundësuar pjesëtarëve të komunitetit joshumicë serb që kanë studiuar në universitetin në Mitrovicën e Veriut, të aplikojnë për punë në institucionet e Kosovës. Në anën tjetër shtoi se janë dhënë 884 bursa për studime të shkollës së mesme gjatë dy viteve të fundit për nxënësit nga radhët e komuniteteve joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe prej tyre, 51 % të

përfituesve kanë qenë vajzat, ndërkaj vitin e kaluar janë dhuruar 55 bursa për studentët nga këto komunitete që ndjekin studimet në universitetet publike, dhe 64 % e përfituesve kanë qenë vajza. Në fund, kryeministri i falënderoi të gjithë partnerët për kontributin e tyre, duke besuar se në takimin e radhës do të mund të vënë në pah zhvillimet specifike në adresimin e të gjithë faktorëve kufizues që zvogëlojnë shanset e grave të komuniteteve pakicë për të kontribuar me aftësitë e tyre në ekonominë e Kosovës dhe jetën e tyre.

## Lansohet platforma elektronike për trajnimin e punëtorëve dhe punëdhënësve për siguri dhe shëndet në punë

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka lansuar platformën elektronike përmes së cilës punëtorët dhe punëdhënësit mund të trajnohen në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Deri tani shumë punëdhënës kanë hasur vështirësi duke paguar kosto të larta për hartimin e dokumenteve të vlerësimit të rrezikut në vendin e punës. Tash e tutje, përmes këtyre

trajnimeve, punëdhënësit do të mësojnë t'i identifikojnë, t'i vlerësojnë rreziqet në kompanitë me rrezik të ulët si dhe ta hartojnë dokumentin për vlerësimin e rrezikut. Për më tepër, ata do të trajnohen për të reaguar në situata emergjente si zjarri, puna në lartësi, dhe rreziqe të tjera që mund ta kërcënojnë sigurinë e punëtorëve.

Në anën tjetër, punëtorët do të trajnohen si të reagojnë në

situata të ndryshme rreziku për ta mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të personave të tjerë që kanë përreth. Këto trajnime janë mundësuar me mbështetjen teknike nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të Punës dhe aktualisht janë në fazën e pilotimit.

Punëdhënësit dhe punëtorët në kompani me rrezik të ulët mund të trajnohen në pesë



module të veçanta. Pas përfundimit me sukses të trajnimit, të trajnuarit pajisen

me certifikatë e cila mund të ruhet në dosjen e punëdhënësit.



# Pa zërin e saj, ajo nuk do ta kishte veten: Kush ishte Maria Callas?

Nga: David SMITH  
*The Guardian*

“Zonja ime është ylli më i madh”.

Këto fjalë thuhet nga Max Von Mayerling, shërbëtori i yllit të tretur në harresë, Norma Desmond, në filmin *Sunset Boulevard*. Por, ato mund të thuheshin po aq lehtë nga Ferruccio Mezzadri, i cili për 20 vjet ishte shërbëtori i divës Maria Callas. Pas tërheqjes nga skena operistike, Callas kaloi një jetë kryesisht të izoluar në Paris.

Mezzadri mbeti shërbëtori i saj besnik dhe i përkushtuar deri në fund – dhe më tej. Gati gjysmë shekulli pas vdekjes së Callasit, ai nuk ka folur kurrë keq për të, as ka zbuluar sekretet e saj. Ai çon një jetë të qetë në Itali, në një shtëpi të mbushur me kujtime, e cila ngjan me një tempull kushtuar sopranos së ndjerë. Por, tani, në moshën 93-vjeçare, Mezzadri e gjen veten papritur dhe sërish në qendër të vëmendjes.

Ai ndau kujtimet e tij për Callasin me skenaristin britanik Steven Knight për Maria-n, një film biografik i Netflix-it që eksploron ditët e fundit të Callasit në Paris, në shtator të vitit 1977, ndërsa ajo reflekton mbi të kaluarën dhe përpjetën të rikthetjes së zërit të saj. Filmi përshkruan një lidhje të veçantë mes Callasit dhe Mezzadrit, i cili, në një moment, shfaqet duke sulmuar një gazetar për ta mbrojtur atë.

Në një skenë tjetër, Callas, e luajtur nga Angelina Jolie, thotë: “Kur të shkruaj autobiografinë time, do ta titulloja Dita kur Ferruccio më shpëtoi jetën”.

Mezzadri, i luajtur nga Pierfrancesco Favino, pyet: “Dhe cila ditë do të ishte ajo, zonjë?”

Callas përgjigjet:

“Çdo ditë. Çdo ditë. Prandaj, të urrej. Bie në një lumë dhe ti gjithmonë më nxjerr jashtë.”

Mezzadri thotë butësisht:

“Po, zonjë”.

Callas pastaj e urdhëron:

“Më rezervoj një tavolinë në kafënë ku kamerierët e dinë kush jam. Jam në disponim për t’u adhuruar”.

Regjinë e filmit Maria e ka bërë Pablo Larraín dhe është i treti në një trilogji jozyrtare – pas filmave të tij të mëparshëm, Jackie, që fokusohet te Jacqueline Kennedy pas funeralit të bashkëshortit të saj John F. Kennedy, dhe Spencer, që përshkruan Princeshë Dianan gjatë një vizite në një nga pronat e Mbretëreshës. Ndryshe nga këto dy gra, të cilat u bënë të famshme për shkak të martesës, Callas – diva e përjetshme (fjala “diva” do të thotë “hyjneshë” në italisht) 0 shpesh dukej sikur fluturonte e vetme.

Ajo lindi në Nju-Jork në vitin 1923 nga prindër emigrantë



grekë. Në moshën 13-vjeçare, u shpërngul në Athinë me nënën dhe motrën e saj dhe u regjistrua në Konservatorin e Athinës, ku iu nënshtrua një trajnimi rigoroz vokal në traditën italiane të bel canto-s. Karrierën e saj profesionale e nisi në moshën 17-vjeçare, duke performuar në Operën Mbretërore të Athinës.

Në fund të viteve '40 dhe në fillim të viteve '50 të shekullit XX, karriera e Maria Callasit lulëzoi në Itali. Suksesi i madh erdhi në vitin 1949 me një interpretim të La Xhokondës në Arenën e Veronës, ku ajo takoi bashkëshortin e saj të ardhshëm, Giovanni Meneghini. Reputacioni i saj ndërkombëtar u konsolidua me performancat e saj në La Scala në Milano, Covent Garden në Londër dhe në Metropolitan në Nju-Jork.

E njohur nga adhuruesit e saj si La Divina (Hyjnorja), Callas ishte e famshme për fleksibilitetin e saj në vokal, aftësinë për të përcjellë një gamë të gjerë emocionesh dhe për përkushtimin e saj ndaj realizmit dramatik. Ajo ishte një pioniere që theu barrierat për gratë në botën e operës, duke kërkuar pagesë të barabartë dhe duke sfiduar status quo-në. Ajo ishte gjithashtu një figurë jashtëzakonisht e pavarur dhe shpesh kontroverze, e njohur për temperamentin e saj labil dhe për standardet e larta. Është cituar të ketë thënë: “Do të jem gjithmonë po aq e vështirë sa është e nevojshme për të arritur më të mirën”.

Megjithatë, në mesin e viteve '50 të shekullit XX, ajo filloi të përjetonte vështirësi në vokal që çuan në anulime koncertesh. Në film, Callas qorton një adhurues që guxon të vërë në

dysim se ajo kishte simuluar sëmundjen për të shmangur një performancë. Teoritë për shkakun e rënies së saj variojnë nga lodhja e tepërt deri te humbja drastike e peshës. Dëshmitë mjekësore sugjerojnë se ajo mund të ketë vuajtur nga dermatomioziti, një sëmundje autoimune që mund të ndikojë në funksionin e muskujve, përfshirë kordat vokale.

Në shënimet e produksionit të ofruara nga Netflix-i, Steven Knight thekson: “Maria kishte marrëdhënien më të ndërlikuar të mundshme me zërin e saj, thujse ndjente se zëri i saj nuk dallonte nga shpirti i saj. Me fjalë të tjera, pa zë ajo nuk e kishte vetveten, ose ndoshta vetja e saj bëhej e padukshme. Ajo gjykohej gjithmonë për zërin e saj dhe, në mënyrë më mizore, për paraqitjen e saj fizike. Ishte tragjedi e vërtetë, në kuptimin e plotë të fjalës, që kur pamja e saj ishte e pranueshme për të, zëri i saj dobësohej. Kur ndihej e shëmtuar, zëri i saj ishte më i fortë. Si mund të përballojë dikush këtë kur zëri është identiteti yt?”

Martesa e Callasit me Meneghinin përfundoi në vitin 1959 dhe ajo filloi një lidhje me magnatin grek të transportit detar, Aristotel Onassis. Marrëdhënia e tyre e zjarrtë dhe e trazuar ishte në qendër të mediave për vite me radhë, duke përfunduar me thyerjen e zemrës së Callasit pasi Onassis u martua me Jacqueline Kennedyn në vitin 1968.

Larraín komenton përmes Netflix-it: “Mendoj se Aristotel Onassis ishte dashuria e jetës së saj dhe mendoj se ata kaluan momente të ndryshme në marrëdhënien e tyre. Ata ishin shpesh të afërt në vitet '70, pas

ndarjes së Onassisit nga Jackie, por ishte gjithashtu një marrëdhënie toksike, mendoj unë. Ajo mund të shpëtohet nga bota dhe të linte çdo gjë nën kontrollin e tij. Besoj se kishte momente në marrëdhënien e tyre që nuk ishin shumë të shëndetshme. Por, mendoj gjithashtu se ata arritën në një mirëkuptim, në fund të jetës së tyre, për atë se si ishin si individë dhe si çift”.

Callas nuk gjeti kurrë një njeri po aq besnik sa Mezzadri, i cili ishte rritur në varfëri dhe, për shkak të një defekti në zemër, nuk mundi të shërbente në ushtri. Në vend të kësaj, ai ishte i detyruar të bënte shërbim social dhe përfundoi duke punuar për gruan e një kompozitori të njohur. Së shpejti, rrugët e tij u kryqëzuan me Callasin dhe ai u punësua si shërbëtor i saj. Ai filloi të punonte për të në Milano dhe më pas e ndoqi atë në Paris, ku mësoi të fliste frëngjisht.

Mezzadri ka qenë subjekt i një monologu skenik, Maria Callas, Perla e Zezë, shkruar nga Federica Nardacci dhe interpretuar nga Marco Gambino. Të dy e takuan atë në shtëpinë e tij në vitin 2018. Gambino, një aktor italian, mbetet në kontakt me Mezzadrin dhe thotë se ai është ende besnik ndaj Callasit.

Duke folur në telefon nga shtëpia e tij në Londër, Gambino, 67 vjeç, shpjegon: “Ai ka këtë ndjenjë mbrojtëse ndaj saj dhe kushdo që përpjetë të ndryshonte gjendjen e saj hyjnore, dënohej ashpër, duke filluar nga z. Onassis e deri te Jacqueline Kennedy. Sa herë që fillon të flasësh për këta njerëz, ai thotë: ‘Jo, jo, jo, jo, ata ishin të këqij, ata ishin të këqij. Zonja

ime ishte aq e ndjeshme dhe ata e shkatërruan atë”.



Pasi u tërhoq nga opera, Callasi dha leksione në Nju-Jork dhe bëri përpjekje të shkurtra për t’u rikthyer në skenë me koncerte dhe një rol filmi. Megjithatë, zëri i saj nuk u rikuperua kurrë plotësisht dhe ajo jetoi në një apartament të mrekullueshëm në Paris, deri në vdekjen e saj nga një sulm në zemër në vitin 1977, në moshën 53-vjeçare. Papritur, Mezzadri iu desh ta fillonte jetën nga e para.

Gambino vazhdon: “Gjërat më interesante që ai tha ishin për veten e tij dhe se si kalimi i 20 viteve me këtë zonjë e bëri jetën e tij të veçantë, por të vështirë për të filluar nga e para pas vdekjes së saj. Ajo vdiq në krahët e tij dhe pas kësaj, kur ke kaluar 20 vjet me dikë të tillë, ku mund të shkosh, çfarë mund të bësh? Ai ishte 40 vjeç, pra gjysmën e jetës së tij e kishte kaluar me të. Ai u përpoq të bëhej shërbëtor për ndonjë aktor, por thjesht nuk mundi. Me paratë që ajo i la – nuk mendoj se ishin shumë – ai bleu një shtëpi të re në të njëjtën zonë ku jetonin prindërit e tij, pranë një shtëpie të vogël afër Piaçencës, dhe aty ka jetuar që atëherë”.

Filmi i Larraínit është shtesa më e fundit në legjendën e Callasit. Interpretimet e saj dramatike, fleksibiliteti në vokal dhe prania e saj mbresëlënëse në skenë ndryshuan përgjithmonë fytyrën e operës. Incizimet e saj, përfshirë interpretimet e veprave Norma, La Traviata dhe Toska, janë ende të nderuara sot. Gambino reflekton: “Gjithçka nisi prej saj: tani këngëtarët e operës duhet të dinë si të aktrojnë dhe jo vetëm si të këndojnë. Kjo është e rëndësishme dhe e bën operën shumë më tërheqëse, sepse shkon në operë për të parë aktrim, përveç këndimit. Ajo donte të ishte aktore, përveçse këngëtare. Për brezat e rinj, mendoj gjithmonë se dikush si Maria Callas mund të jetë një mënyrë për të takuar operën në një mënyrë më ndryshe dhe më emocionuese, sepse ajo është si një yll i muzikës rok. Po shikoja disa fragmente të kohës, kur ajo u kthye në Metropolitan në vitet '50 dhe njerëzit prisnin në radhë për 24 orë. Moshë mesatare e këtyre njerëzve ishte rreth 15-16 vjeç sepse ajo ishte një divë, por jo vetëm kaq. Ajo ishte një performuese e jashtëzakonshme”.

Ai shton: “Zëri i saj nuk ishte ai zëri i bukur që të garanton një performancë të mahnitshme. Zëri i saj ishte, në fakt, edhe më interesant, sepse ajo mund të dështonte. Ajo që më pëlqen te Maria Callas është e papritura, të metat që althohen me momente hyjnore. Kur je e tillë, ato momente të përsosmërisë nuk mund të krahasohen me asnjë performancë tjetër. Je unike”. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# 'Ylli i javës' në Superligë, Thaqi: Synojmë garat evropiane

"Epoka e re",

GJILAN, 17 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 17 në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të SC Gjilanit, Armend Thaqi. Vlerësimi për më të mirin e javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Lulzim Berishës, Enver Prapashticës dhe Berat Berishës. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e shtatëmbëdhjetë t'i jepet Armend Thaqi, i cili ishte hero i "skifterave" me golin e vetëm në ndeshje, duke mposhtur rivalen e qytetit, FC Dritën, me rezultat 1:0, dhe duke arkëtuar tri pikë të rëndësishme për skuadrën e tij. Pasi mori këtë çmim, Thaqi u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Po, tradicionalisht dihet që është derbi, një nga më të mëdhenjtë në rajonin tonë. Është një ndeshje që çdo futbollist do të donte ta luante, pasi është ajo që të bën të ndihesh futbollist. Fitimi i tij sjell shumë përfitime, përfshirë rikthimin e besimit në skuadër. Edhe pse ishim në një çast të vështirë në tabelë dhe bëmë disa gabime, fitorja na solli tri pikë të rëndësishme që na kthyen qetësinë dhe atmosferën pozitive. Kur fiton derbin, jo vetëm që mposht rivalin në tabelë, por fiton rivalitetin e qytetit, që është një motiv i



jashtëzakonshëm për ndeshjen e ardhshme". "Kjo fitore na jep besim për ndeshjet që na presin dhe për sezonin pranveror. Klubi ka bërë investime të mëdha dhe ne jemi të motivuar të arrijmë një vend në garat evropiane, që do të ishte një objektiv shumë i merituar. Për mua, ky çmim

individual është shumë i rëndësishëm, por nuk është vetëm meritë e imja. Ky është një çmim që ia dedikoj trajnerit Ardian Nuhiu dhe të gjithë futbollistëve, pasi ky sukses është rezultat i angazhimit të gjithsecilit", ka deklaruar Thaqi për faqen zyrtare të FFK-së.

SHKURT

## Aro Muriqi në ekipin e javës në Premierligë

Aro Muriq po e vazhdon shkëlqimin në Premierligën angleze. Portieri i Kombëtares së Kosovës e bëri një paraqitje fantastike për Ipswich Townin në ndeshje me Wolverhampton Wanderersin në fundjavën që shkoi. Prandaj, faqja e specializuar "WhoScored" e ka përfshirë portierin shqiptar nga Mali i Zi në formacionin e javës në ligën elitare angleze. Ipswichi fitoi me rezultat 2-1 në udhëtim në kuadër të xhiros së 16 dhe Muriqi ishte i jashtëzakonshëm me pritjet e tij, duke ia mundur ekipit të tij t'i fitojë këto tri pikë të vlefshme. Për këtë, "Whoscored" e vlerësoi portierin "dardan" me notën 8,31. Kjo nuk është hera e parë që Muriqi e gjen veten në formacionin ideal të javës në Premierligë, ndonëse i pati disa xhiro kur bëri gabime trashanike dhe kur tifozët e Ipswichit kërkuan që ai të përfundojë në bankinë. 26-vjeçari i ka zhvilluar 15 ndeshje në Premierligë në këtë sezon deri tash.

## Shaqiri dhe Rrudhani, pjesë e formacionit të javës në Zvicër

Vazhdon shkëlqimi i futbollistëve shqiptarë në kampionatin zviceran që çdo javë po lënë gjurmë. Edhe në xhiron e 18 në formacionin më të mirë të javës janë përfshirë dy futbollistë nga Kosova. Xherdan Shaqiri humbi me Baselin e tij në shtëpi 0-1 nga Grasshoppersi, megjithatë ai ishte më i miri në fushë duke marrë notën 8,4. Përveç Shaqirit, në formacionin e javës ishte edhe Donat Rrudhani që pati paraqitje spektakolare me Luzernin. Reprzentuesi dardan mori notën 9,4, duke shënuar gol dhe duke asistuar në një tjetër në fitoren e Luzernit 3-4 në udhëtim te Winterthuri.

## Gjimshiti, 200 ndeshje me Atalantën në Serinë A

Berat Gjimshti luan ndeshjen e tij të 200 me Atalantën në Serinë A. Aktivizimi në pjesën e dytë e mbrojtësit kuqezi në sfidën e javës së 16 ndaj Cagliariarit ishte e 200 në karrierë në elitën e futbollit italian me fanellën e bergamaskëve për Gjimshtin. Një arritje e rëndësishme për mbrojtësin, i cili është kthyer në një element shumë të rëndësishëm të këtij klubi, me statistikat që tregojnë qartësisht. Rezulton se që nga viti 2019 e deri më sot ai ka koleksionuar 600 duele ajrore të fituara, 392 topa të vjedhur ndaj kundërshtarëve, 257 pasime të ndaluara dhe 790 duele në tokë të fituara. Në këtë mënyrë ai është lojtari i cili ka numrin më të lartë të statistikave të përgjithshme në krahasim me të gjithë shokët e repartit të mbrojtjes, ndërsa në dy sezonet e fundit rezulton se ka qenë numri 1 brenda skuadrës në secilën prej këtyre statistikave. Edhe klubi i Atalantës nuk ngurroi ta uronte Gjimshtin për këtë arritje me klubin zikaltër, duke postuar në faqen zyrtare të klubit urimin për kapitenin tonë kuqezi.

# Takime interesante në Ligën Unike të meshkujve

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Të mërkurën do të zhvillohen katër ndeshjet e javës së parë të Ligës Unike Meshkujt. Në këtë xhiro do të përballen katër skuadrat nga Shqipëria me ato të Kosovës. Dy ndeshje do të zhvillohen në

LIGA UNIKE MESHKUJ - JAVA 1

GRUPI A

Të mërkurën takohen:

17:00 Besëlidhja - Bashkimi  
18:00 Teuta - Vëllaznimi

GRUPI B

Të mërkurën takohen:

19:00 Sigal Prishtina - Vllaznia



Shqipëria, dy në Kosovë. Në Grupin A, Besëlidhja do të përballen me Bashkimin, kurse Teuta do të ndeshet me Vëllaznimin. Përballje mjaft interesante janë ato të Grupit

B, ku Sigal Prishtina do të ndeshet me Vllazninë, takim që do të zhvillohet në Shkodër, ndërsa ish-kampioni, Golden Eagle Ylli, e pret Tiranën.



## Seferi premton se do të festojë me shqiptonjë nëse shënon ndaj Serbisë

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ekipi kuqezi për në kualifikueset e Botërorit 2026 do të kalojë në Grupin K ku pjesë janë Anglia, Serbia, Andorra dhe Letonia. Taulant Seferi tregon se ka folur me shokët e Kombëtares për grupin, ndërsa premton se do të festojë me shqiptonjë nëse

shënon në transfertën e Serbisë. "Po e përcillja shumë mirë. Është një grup shumë i fortë. Kur na ra Serbia direkt mendova se do të jetë një kompeticion shumë emocional për të gjithë ne lojtarët. U kam thënë edhe shokëve që duhet të jemi me kokën e ftohtë dhe me

zemrën flak, megjithëse e presim padyshim. Si profesionist padyshim mendoj se do të jetë më ndryshe nga kualifikueset atëherë. Tani do të shohim më shumë futboll. Në atë kohë ka pasur shumë provokime nga ana e serbëve dhe ka eskaluar situata.

Gjithçka që dëshiroj të them dhe që shpresoj është që në këto dy ndeshje ta tregojmë veten si profesionistë. T'i fitojmë të dy ndeshjet ndaj Serbisë dhe të kemi një kualifikuese shumë të suksesshme", ka thënë Seferi. "A do të festoj me shqiptonjë në Beograd? Padyshim, e



kemi shqiptonjën në zemër në mes të Beogradit. Do zoti shënoj dhe padyshim që po", u shpreh Seferi për "Klan Kosova".

## Fundi i epokës së Guardiols, apo një 'gërvishtje' pa pasoja të rënda?

MANCHESTER, 17 DHJETOR - Ajo pamje e gërvishtjeve në kokën dhe fytyrën e Pep Guardiols vështirë se do të harrohet nga ata që kanë pasur kënaqësinë ta ndjekin evolucionin e futbollit në shekullin XXI, falë tij.

Trajneri i Manchester Cityt po kalon një seri negative që pakkush do ta besonte të ishte e mundur (vetëm një fitore në 11 ndeshje!) dhe, pas derbit të Manchesterit dhe fitores së Ruben Amorimit në shtëpinë e rivalit, pranoi se nuk është "mjaftueshëm i mirë". Duke parë rezultatet, është e vërtetë që është gjithnjë më e vështirë për ta kundërshtuar këtë. Nuk është hera e parë që trajneri më i mirë i dekadave të fundit dhe një nga më të mirët në historinë e këtij sporti duhet të justifikojë periudha të dobëta, por është interesante të analizohen argumentet e Pepit javët e fundit dhe dëshpërimi i tij në rritje. Faji fillimisht u vuri fajin dëmtimeve. Sigurisht që kur humb lojtarin që fiton "Topin e Artë", është e sigurt që ke arsye për t'u ankuar, por në një skuadër me praktikisht kufij financiarë të pakufizuar,



kjo tingëllon si një justifikim i dobët. Gjithashtu, fakti që kjo skuadër ka fituar gjithçka nuk ndihmon. Mënyra se si ky Manchester City (një klub me pak histori para investitorëve arabë) u bë një gjigant i futbollit është një nga sekretet e trajnerit katalanas, por duket se as ai nuk po arrin t'i motivojë "yjet" për të fituar gjithmonë. Madje provokimet ndaj tifozëve të Liverpoolit dhe përplasjet me Jose Mourinhon për 115 akuzat kundër Manchester Cityt do të ishin momente argëtimi ose admirimi, nëse do të kishte një

reagim në fushë. Por kështu si janë gjërat, ato janë thjesht të trishtueshme. Tani, pasi ka rinovuar kontratën me klubin dhe ka garantuar se nuk do të largohet, as nëse skuadra bie nga kategoria për shkak të ndonjë ndëshkimi, Guardiola, faktikisht, nuk po është mjaftueshëm i mirë për të gjetur zgjidhje që t'i kapërcejnë dëmtimet, mungesën e motivimit dhe kundërshtarët, të cilët nuk kanë nevojë për shumë për të qenë më të mirë. Po ndjekim një debat të brendshëm dhe të jashtëm të figurës që ende frymëzon trajnerët të luajnë në një mënyrë të caktuar, edhe kur nuk kanë burimet për ta bërë. Nuk është aspak një pamje e bukur, por nëse zgjidhja për të fituar gjithmonë do të ishte gjetur, do të kishte më pak emocion. Edhe pse gjithçka po shkon keq, ka shumë që besojnë se Pep do të gjejë një rrugëdalje, duke shpikur një mrekulli të menjëhershme. Për gjithçka që ka bërë në futboll dhe për atë që ende do të bëjë, e vërteta është se shenja që ka lënë Guardiola është shumë më e thellë se këto gërvishtje.

### SHKURT

#### Laçi pjesë e formacionit më të mirë në Çeki

Qazim Laçi ka vazhduar ta tregojë formën e shkëlqyer me Spartën e Pragës, duke kontribuar në fitoren 2-1 ndaj Jablonecit në kuadër të kampionatit çek. Mesfushori shqiptar ka dhuruar dy asistime të shkëlqyera në këtë ndeshje, duke luajtur një rol kyç në suksesin e skuadrës së tij. Këto paraqitje e kanë renditur atë në formacionin më të mirë të javës në Çeki, një nder i madh për lojtarin dhe një vërtetim i aftësive të tij. Laçi, i cili ka qenë një nga lojtarët më të dalluar të Spartës këtë sezon, ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në lojën e skuadrës. Asistimet e tij ishin të përpiluara me saktësi, duke mundësuar që shokët e tij të shënojnë gola të rëndësishëm. Përveç kontributit të tij në sulm, Laçi ka dhënë mbështetje të fortë në mesfushë, duke ndihmuar në kontrollimin e ritmit të lojës dhe ekuilibrin e ekipit.

#### Montoja: Nëse Ferrari do të jetë kompetitiv, Hamiltoni pas 6-7 garash do ta fitojë duelin me Leclercin

Ish-piloti kolumbian Juan Pablo Montoja beson se transferimi i Lewis Hamiltonit nga Mercedesi te Ferrari nuk ishte një rastësi. Ai beson se britaniku, shtatë herë kampion bote në Formula 1, do ta kërkojë titullin e tetë me "kokëkuqen". Madje Montoja beson se Hamiltoni mund ta mposhtë shokun e tij të ri të skuadrës Charles Leclerc. "Lewis është i pjekur. Do t'i mjaftojë pak kohë për të kuptuar dhe mësuar mekanizmat e punës te Ferrari, ta njohë makinën dhe ekipin. Natyrisht që Leclerci do të ketë një avantazh në fillimin e sezonit, por nëse makina është konkurruese pas 6-7 garash, Hamiltoni do të fitojë gjithçka", ka thënë Montoja. "Hamiltoni e tregoi veten edhe këtë sezon në timonin e Mercedesit, ndërkohë që aftësitë e tij nuk i vë askush në diskutim. Në letër atij do t'i duhet një vit të përshtatet, por mendoj se do ta vërë shpejt nën presion Leclercin. Është e qartë që ai mezi pret ta nisë mbarë këtë aventurë të re", ka deklaruar Juan Pablo Montoja.

#### Yamal: Dua të fitoj një Ligë të Kampionëve ose një Kupë të Botës përpara 'Topit të Artë'

Lamine Yamal është një lojtar skuadre dhe asgjë nuk flet më shumë për karakterin e yllit të ri të Barcelonës sesa komentet e tij të fundit për fitimin e mundshëm të "Topit të Artë". Sensacioni 17-vjeçar ka arritur të lë gjurmë të mëdha tashmë në futbollin evropian, duke qenë një nga lojtarët kryesor të Spanjës në triumfin e tyre në Kampionatin Evropian. Paraqitjet e tij të mira me Spanjën dhe Barcelonën kanë bërë që Yamal të cilësohet një nga fituesit e ardhshëm të çmimit më të madh individual, "Topi i Artë". Megjithatë, sulmuesi anësor ka treguar se prioritet i tij janë çmimet ekipore edhe me kombëtaren, përpara çmimit individual. "Përpara një 'Topi të Artë' do të doja një Ligë të Kampionëve ose një Kupë Botërore", ka thënë Yamal. Agjenti Jorge Mendes, i cili ka Lamine në listën e klientëve të tij të profilit të lartë, beson se i diplomuari në La Masia është i destinuar për madhësi. "Lamine [Yamal], ju do të fitoni 'Topin e Artë' vitin e ardhshëm", ka deklaruar Mendes gjatë galasë së Golden Boy.

## Cavaliersi dominon në Lindje, Jokiqi udhëheq Denverin me 'triple double'

SACRAMENTO, 17 DHJETOR - Cleveland Cavaliersi mbetet në krye të renditjes në NBA pas fitores me rezultat 130-101 ndaj Brooklyn Netsit jashtë fushës. Ndeshje e dominuar nga miqtë, ku për Cavaliersin shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, duke



bërë dallimin. Fitore në sekondën e fundit për Denverin, që mundi 130-129 Sacramenton, sfidë ku shkëlqeu sërish Nikola Jokiqin me një "triple double" (20 pikë, 14 rebounde e 13

asistime). Shënuesi më i mirë për miqtë ishte Murray me 28 pikë. E njëjta situatë edhe në fitoren me rezultat 125-124 të Detroit Pistonsit ndaj Miami Heatit, sukses që erdhi në kohën shtesë. Butleri realizoi 35 pikë, por që s'mjaftuan për Miamin, ndërsa për Pistonsin u dallua Beasley me 28 pikë. Në fund fitoi edhe Chicago, 122-121, në fushën e Torontos, sfidë ku për Bullsat u dallua stoli, nga erdhën 50 pikë. Jashtë fushës fiton Philadelphia, që falë 40 pikëve të Maxeyt, mundi me rezultat 121-108 Charlotte.

### REZULTATET

Charlotte - Philadelphia	108-121
Detroit - Miami	125-124
Brooklyn - Cleveland	101-130
Toronto - Chicago	121-122
Sacramento - Denver	129-130
Clippers - Utah Jazz	144-107

## Dështoi në testet anti-doping, Mudryk rrezikon pezullimin për katër vjet nga futbollit

Sulmuesi ukrainas i Chelsea, Mykhailo Mudryk, rrezikon pezullimin nga futbollit i luajtur për katër vjet. Shkak

për këtë është bërë një test rutinor anti-doping që Mudryk ka kryer së fundi, ku ka rezultuar pozitiv. Sipas medieve në Ukrainë,

sulmuesi 23-vjeçar i Chelsea rrezikon thajse të njëjtin dënim si Paul Pogba. Ai nuk ka luajtur me "Blutë e Londrës", që pas sfidës në

Evropa Ligë ndaj ditur faktin se për të gjermanëve të londinezët shpenzuan 70 Heidenheimit. Për milionë euro verën e shkuar Chelsea ky do të ishte një për ta afruar nga skuadra e lajm vërtet shokues, duke Shakhtarit.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT




# SWISS

## TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





# Lume's Details


## Estetik & Depilim




 044 900 978 | 045 681 898


 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada-Government  
 Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

### FTESË PËR OFERTIM PËR DHËNJE ME QIRA TE LOKALEVE

**Datë 18.12.2024** **Referenca: AAPSK- 016/2024**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për dhënie me qira të Lokaleve ne Prizren, sipas përshkrimit të më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Çmimi Fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Lokal 174 m <sup>2</sup> , kati përdhes, nr. Rruga "Tirana" Prizren Lokali është i ndërtuar ne pjesën e objektit "Albanika", ne Prizren, dhe posedon: Pjesa e hyrjes se lokalit dhe Banjon	Total: 2,660.00€ për muaj	
2	Lokal 92m <sup>2</sup> , kati përdhes, nr. Rruga "Tirana" Prizren Lokali është i ndërtuar ne pjesën e objektit "Albanika", ne Prizren, dhe posedon: Pjesa e hyrjes se lokalit dhe Banjon		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më: 26.12.2024 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes( në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit objektet mund ti shikojnë me datë: 23.12.2024, prej orës 11:00-12:00 në adresën e lartë shënuar.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara në këtë procedure te ofertimit procedohen me Qira, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë.

Vërejtje: Lokalet gjenden ne dy njësi kadastrale por meqenëse gjendja faktike është se janë te bashkuara ne një, atëherë lokalet lëshohen me qira ne tersi te m<sup>2</sup> dhe çmimit total për qira mujore.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Lokalet do ti jepen në shfrytëzim me qira ofertuesit që ofron çmimin më të lartë për muaj.

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Anel Aliti shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren.
- Aldena Fazli shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- Gardjan Zeneli shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- Lindihana Jusufi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.
- Islam Hasanaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit " Compania Hasanaj" sh.p.k. me numër Identifikues: 810247206.
- Endrit Dhomi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044\558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

